



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
DREJTORIA E AUDITIMIT

Nr. 4084/prot.

Tiranë, më 28.07.2022

MIRATOI
DREJTORI I AUDITIMIT
LULJETA NANO



PROGRAM I ANGAZHIMIT TË AUDITIMIT

PËR AUDITIMIN E SHKOLLËS SHQIPTARE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Në zbatim të planit të auditimeve për vitin 2022, i miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm me shkresën nr. 2662, datë 09.05.2022, Drejtoria e Auditimit do të angazhohet në një mision auditimi.

Objekti i auditimit:

Vlerësimi nëse veprimtaritë e kryera në institucionin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, janë kryer në pajtim me kuadrin ligjor dhe nënligjor, aktet e brendshme dhe rregulloret. Përcaktimi i nivelit të përputhshmërisë të veprimtarisë së njësisë për realizimin e objektivave, zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, rregullave të detyrueshme, standarteve, planeve kontratave, politikave dhe procedurave që përcaktojnë zonën që do të auditohet. Vlerësimi i zbatimit të procedurave në kuadër të projektit IPA2014/05.

Lloji i auditimit:

Auditim përputhshmërie mbi bazë sistemi dhe auditim i kombinuar për implementimin e projektit IPA 2014/05, Aktiviteti 7 “Forcimi i kapaciteteve të ASPA, në menaxhimin dhe kryerjen e cilësisë së trajnimeve”.

Subjekti i audituar:

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).

Qëllimi i auditimit:

Të ndihmojë Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, në realizimin e objektivave të veprimtarisë së saj, duke përmirësuar sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit objekt auditimi.

Metoda e auditimit:

Auditimi në bazë sistemi, duke përdorur si metoda dhe teknika, intervista, pyetësor, rishikim të dokumentacionit, analiza, ekzaminim kryq, testim i detajuar, përcaktim/regjistrim i sistemeve proceseve nëpërmjet kërkit paraprak etj.

Baza ligjore:

- Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”.
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.
- Ligji nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.
- Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
- Ligjet vjetore për zbatimin e buxhetit të shtetit: Ligji nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”; Ligji nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”.
- Vendimi nr. 138/2014 “Për rregullat e organizimit dhe funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civil” i ndryshuar.
- Urdhri i Kryeministrit nr.106, datë 13.08.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shkollës Shqiptare të Administratës Publike”.
- Urdhri i brendshëm nr. 142 datë 31.12.2021, “Për miratimin e Rregullores së Etikës së Shkollës Shqiptare të Administratës Publike”.
- Rregullore e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të ASPA-S.
- VKM nr.187, datë 8.3.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e lartë, Prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, i ndryshuar.
- VKM Nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar.
- VKM nr.929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 893, datë 17.12.2014, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm “ i ndryshuar, me VKM nr. 666 datë 10.11.2021.
- VKM nr. 717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës në institucionet buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”.
- VKM nr. 234 datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe të punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”.

- VKM 673 datë 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë.
- Ligji Nr.9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”.
- Ligji nr.37, datë 9.04.2015 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Asistencës së Para- anëtarësimit IPA II”.
- Rregullorja (EU) Nr 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 11 mars 2014 për vendosjen einstrumentit të parazgjerimit .
- Vendimi Nr.23, datë 12.1.2011 “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të parazgjerimit (IPA), Komponenti I: Asistenca e (IPA) II tranzicionit dhe forcimi institucional”.
- Vendimi Nr.707, datë 21.8.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 23, datë 12.1.2011 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të parazgjerimit (IPA), Komponenti I: Asistenca e tranzicionit dhe forcimi institucional”, të ndryshuar.
- Vendimi Nr.541, datë 18.06.2015 “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të asistencës së para-anëtarësimit IPA II (2014 – 2020)”.
- Marrëveshja operationale midis palëve Koordinatorit Kombëtar IPA (NIPAC) dhe Drejtorisë së Përgjithshme për Financimin dhe Kontraktimin e fondeve të BE-së ËB e donatorëve të tjerë (HoCFCU) dhe HIPAU për implementimin e menaxhimit indirekt të IPA II të Asistencës ndaj Shqipërisë Versioni 2-nëntor 2016.
- Dokumenti i veprimit për Programin IPA 2014 për Shqipërinë në përputhje me Marrëveshjen Financiare, Action nr 1.4 “Mbështetja e Reformës në Administratën Publike”.
- Standardet Ndërkombëtare i Praktikave Profesionale të Auditimit të Brendshëm të Institutit të Audituesve të Brendshëm.
- Manuali i Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik.
- Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
- Udhëzimi MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Udhëzimet e Ministrisë së Financave për procedurat e hartimit të projekt buxheteve afatmesme, të zbatimit të buxheteve vjetore si dhe procedurat standarde të monitorimit të buxhetit.
- Si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore dhe nën ligjore që lidhet me veprimtarinë e subjektit dhe misionin e auditimit.

Periudha që do të auditohet:

Auditimi do të kryhet për 01.01.2021 – 30.06.2022.
Për implementimin e aktiviteteve të projektit IPA,
shtrihet dhe në periudha të mëparshme.

Afati i auditimit :

Auditimi do të fillojë me datë 28.07.2022 dhe do të
përfundojë me datë 20.09.2022.

Grupi i auditimit:

Luljeta Nano - Përgjegjëse grupi
Marjana Kureta - Anëtar

Drejtimet e auditimit :

I. Auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.

1. Vlerësimi i komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Vlerësimi i mjedisit të kontrollit, menaxhimit të riskut, kontrollit të aktiviteteve, informim komunikimi dhe monitorimi.

II. Auditimi i sistemit të drejtimit dhe administrimit të trajnimeve.

1. Mbi ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Drejtues, konform përcaktimeve të kuadrit rregullator.
2. Mbi organizimin e sistemit të trajnimeve, sigurimit të cilësisë së trajnimeve, kontratave të lidhura me trajnerët, sistemi i pagesave etj.

III. Auditimi i sistemit të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit.

1. Vlerësimi i procedurave të ndjekura për programimin e nevojave, përgatitjen e projektbuxhetit afatmesëm dhe planit vjetor të buxhetit.
2. Vlerësimi i procedurave të zbatimit të buxhetit, raportimit dhe monitorimit të performancës buxhetore.

IV. Auditimi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe sistemit të pagave.

1. Zbatimi i kuadrit rregullator për menaxhimin e burimeve njerëzore, respektimi i strukturës organizative, organikës dhe limiteve të miratuara.
2. Vlerësimi i rregullshmërisë së sistemit të pagave, të përgatitjes së listë pagesave dhe kryerjes së pagesave etj.

V. Auditimi i sistemit të prokurimeve publike.

1. Planifikimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve për fondet publike, mallra shërbime, punë publike të depozituar pranë Degës së Thesarit, në fillim të çdo viti buxhetor, si dhe ndaj çdo rishikimi të tij gjatë vitit ushtrimor.

2. Zbatimi i dispozitave ligjore për prokurimet me fonde publike, (programimi, parashikimi, përlogaritja e fondit limit, përgatitja e dokumentacionit, procedura e prokurimit, lidhja e kontratave).
3. Zbatimi i kontratave dhe marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara/shërbimeve sipas llojit të tyre.

VI. Auditimi i sistemit të pagesave dhe administrimit, inventarizimit, ruajtjes dhe lëvizjes së aktiveve qarkulluese dhe të qëndrueshme .

1. Vlerësim i ligjshmërisë së kryerjes së pagesave nëpërmjet bankës, arkës për shpenzimet operative administrative si dhe kontratave të shërbimeve, mallrave dhe investimeve dhe likuidimi i pagesave bazuar në dokumentacion justifikues.
2. Vlerësim i ligjshmërisë së përdorimit të fondit të veçantë.
3. Zbatimi i kuadrit rregullator në marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara.
4. Auditimi i procedurave të menaxhimit, administrimit, vlerësimit, ruajtjes së aktiveve. Regjistri i aktiveve. Vlerësim i sistemit të kontrollit periodik të aktiveve.
5. Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve në magazinë e përdorim, rakordimi me kontabilitetin.

VII. Auditimit i sistemit të kontabilitetit dhe raportimit financiar.

1. Mbajtja e kontabilitetit, dhe zbatimi i procedurave në përgatitjen e pasqyrave financiare.
2. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.
3. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

VIII. Auditimi mbi implementimin e projektit AL/IPA 2014/05, Aktiviteti 7 “Forcimi i kapaciteteve të ASPAS në menaxhimin dhe kryerjen e cilësisë së trajnimeve”.

1. Funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm e zbatimi i procedurave në implementimin dhe monitorimin e realizimit të aktivitetit/nënaktiviteteve dhe produkteve sikurse programuar.

VI. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

Të tjera probleme që dalin gjatë angazhimit të auditimit lidhur me zbatimin e programit të angazhimit të auditimit.

GRUPI I AUDITIMIT

Luljeta Nano

Marjana Kureta